



VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUGISHËM  
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROŠEVAÇ



Më  
 Dana 27.08.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
 GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:048181  
 Datë: 31.08.2018  
 Numri i dokumentit: 00110799

P. nr. 3287/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi, dhe procesmbajtësen Mimoza Shabani, bashkëpunëtoren profesionale, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 lidhur me para.1 nënpar 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2183-7/2017 të datës 26 dhjetor 2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, të dëmtuarës [REDACTED] si dhe të pandehurit [REDACTED], me datën 08.08.2018 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 15.08.2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri: [REDACTED] i lindur më [REDACTED] në Ferizaj, me vendbanim në fshati [REDACTED] K. Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED], e gjinisë [REDACTED] i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 08 Tetor 2017, rreth orës 09:00, në fshatin [REDACTED] K. Ferizaj, përkatësisht në shtëpinë e tij, i pandehuri e sulmon fizikisht të dëmtuarën – bashkëshorten e tij [REDACTED]

███ në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje, e godet të njëjtën me grusht në pjesën e shpinës, ku si pasojë e goditjes të dëmtuarës i shkaktohen lëndime të lehta trupore, e të cilat lëndime bazuar në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 20 Dhjetor 2017 bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

me të cilën ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par. 3 lidhur me par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së

Andaj, gjykata në bazë nenit 188 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42,49, 51, 64, 65 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, e

### G J Y K O N

- Të pandehurin ███, me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 /një/ viti, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale.
- E dëmtuara ███ nga Fshati Dubravë K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzet euro / si dhe shpenzimet e procedurës penale ekspertiza mjekoligjore shumën prej 20 Euro / njëzet euro/, në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohen të akuzuarit që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar të pandehurin gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria themelore në Ferizaj, me aktakuzën e evidentuar PP. II.nr. 2183-7/2016 të datës 26 Dhjetor 2017, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par. 3 lidhur me par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 08.08.2018, në të cilën shqyrtim i akuzuari [REDAKTUAR] u deklarua fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza sipas të gjitha pikave, i premtun gjykatës se më nuk do te përsëris vepra penale, është i pa punë, mbajtësi familjes, lut gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të butë .

Prokurori i Shtetit Albert Zejnullahu duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënimin e merituar.

E dëmtuara [REDAKTUAR] ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk paraqet kërkesë pasurore juridike, kanë raporte burrë - grua me të pandehurin, kanë dy fëmijë, dhe nga ajo ditë nuk kanë pasur më mosmarrëveshje.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë: ekspertiza mjeko-ligjore e dt.20.12.2017, deklarata e të dëmtuarës [REDAKTUAR] e dt.31.10.2017, si dhe deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt.11.10.2017.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehte truppo nga neni 188 par.3 lidhur me par. 1 nënpar 1.4 sikurse me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, i gjendjes së dobët ekonomike, ka qenë hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P.nr. 3287/17 datë 15.08.2018.**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Mimoza Shabani**

**Gjyqtari: Ilir Bytyqi**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.